



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 461 Vendimi
Tiranë, më 20.10.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Alma Faskaj	Kryesuese
Firdes Shuli	Anëtare
Suela Zhegu	Anëtare,

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në mjediset e punës së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket:

SUBJEKTI TË RIVLERËSIMIT: Znj. Dashurije Gjunksi, me detyrë inspektore në ish-Këshillin e Lartë të Drejtësisë.

BAZA LIGJORE:

Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet Ç, D, Dh dhe E, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, germa “a”; pika 1, e nenit 64;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”.

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Me shkresën nr. *** prot., datë 15.1.2020, Komisionit të Pavarur të Kualifikimit i është njoftuar Urdhri nr. ***, datë 30.10.2019, i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, “Për lirimin nga detyra”, të znj. Dashurije Gjunksi, në detyrën e inspektore në ish-Këshillin e Lartë të Drejtësisë.
2. Referuar parashikimit kushtetues të nenit 84/3, të datës së miratimit të ligjit nga Parlamenti dhe datës të botimit të ligjit në Fletoren Zyrtare, si dhe vendimeve të Gjykatës Kushtetuese për pezullimin dhe rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin, ligji hyri në fuqi në datën 8.10.2016.
3. Në datën 25.10.2016, ligji u pezullua nga Gjykata Kushtetuese dhe, për këtë arsye, afati i zbatimit të ligjit eci për 17 ditë deri më 19.1.2017. Në datën 18.1.2017, Gjykata Kushtetuese rrëzoi kërkesën për shfuqizimin e ligjit dhe ky vendim u botua në Fletoren Zyrtare më 19.1.2017. Si rezultat, afati 30-ditor në dispozicion të subjekteve të rivlerësimit për dorëzimin ka përfunduar në datën 31.1.2017.
4. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për znj. Dashurije Gjunksi me detyrën e inspektore së ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka filluar menjëherë me:
 - a. plotësimin dhe dërgimin e deklaratës së pasurisë, sipas shtojcës 2, të ligjit nr. 84/2016, në ILDKPKI, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31;
 - b. plotësimin dhe dërgimin e deklaratës për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3, të ligjit nr. 84/2016, në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35;
 - c. plotësimin dhe dërgimin e formularit të vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 41.
5. Trupi gjykues i shortuar për këtë qëllim është i përbërë nga komisionerët:

Alma Faskaj	Kryesuese
Firdes Shuli	Anëtare
Suela Zhegu	Anëtare

II. ARSYET PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

6. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
7. Pika 3, e nenit 179/b, të Kushtetutës parashikon se procesi i rivlerësimit i nënshtrohen të gjithë gjyqtarët duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, duke iu nënshtruar *ex officio*.

8. Trupi gjykues ka konstatuar se znj. Dashurije Gjunksi ka ushtruar detyrën e inspektorit pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe me shkresë nr. *** prot., datë 31.10.2019, Komisionit i është përcjellë vendimi nr. ***, datë 22.10.2019, “Për vlerësimin e statusit individual dhe karrierën për znj. Dashurije Gjunksi”, në të cilin është vendosur “deklarimi i mospasjes së statusit ‘Magjistrat’ për znj. Dashurije Gjunksi”.
9. Me vendimin nr. ***, datë 30.10.2019, Këshilli i Lartë i Gjyqësor ka vendosur “lirimin nga detyra të znj. Dashurije Gjunksi, në detyrën e inspektore së ish-Këshillit të Lartë Drejtësisë”. Komisioni iu drejtua Këshillit të Lartë Gjyqësor, nëse ndaj vendimit nr. ***, datë 22.10.2019, është ushtruar ankim në Gjykatën Administrative të Apelit. Këshilli i Lartë Gjyqësor, me shkresën nr. *** prot., datë 29.9.2021, informon se me anë të komunikimit elektronik është kërkuar në Gjykatën Administrative të Apelit informacioni nëse znj. Dashurije Gjunksi ka ushtruar ankim ndaj vendimit nr. ***, datë 22.10.2019, e cila në rrugë elektronike me e-mail-in e datës 27.9.2021, ka informuar se deri më 27.9.2021, nuk ka paraqitur ankim kundër vendimit të mësipërm.
10. Trupi gjykues çmon se objekti për të cilin kishte nisur procedura e rivlerësimit apo qëllimi i këtij procesi është bërë i pamundur, referuar nenit 95 “Pamundësia në objekt apo qëllim”, të Kodit të Procedurës Administrative, i cili specifikon: “*Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur*”.
11. Në pikën 6, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, nëse këto procedura nuk janë të parashikuara nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në pikën 6, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në germën “c”, të pikës 1, të nenit 64, të ligjit nr. 96/2016,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar për znj. Dashurije Gjunksi me detyrë inspektore në ish-Këshillin e Lartë të Drejtësisë, pa një vendim përfundimtar të çështjes, për shkak se objekti për të cilin ka nisur procedura është bërë i pamundur.
2. Ky vendim i njoftohet znj. Dashurije Gjunksi, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë.
3. Ankimi kundër këtij vendimi bëhet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisionerit Publik, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 20.10.2021

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Alma FASKAJ
Kryesues

Firdes SHULI
Anëtare

Suela ZHEGU
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Denisa Kosta